

REPUBLIKA E SHQIPERISË



BASHKIA KRUIJË
Këshilli i Bashkisë

Nr. _____ Prot

Krujë më ____/____/2016

VENDIM

Nr. 37 datë 04 / 07 2016

"Për miratimin e pagave të Administrates së Bashkisë Krujë dhe Njësive Administrative.

Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e tij të datës 04/07/2016, mbështetur në VKM nr.165 datë 02.03.2016 "Per grupimin e njesive te vetqeverisjes vendore per efekt page dhe caktimin e kufijve te pageve te funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjesve administrativë te njesive të Vetëqeverisjes Vendore", nenit 5/25 të ligjit nr.10405, datë 24.03.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr.147/2015, datë 24.12.2015 "Për buxhetin e vitit 2016", VKM nr.83 datë 03/02/2016 "Për krijimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm ", VKM nr.965 datë 02.12.2015, p.24 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave", VKB Nr. 28 datë 31/5/2016 "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Krujë e institucioneve në varësi" si dhe vendimi Nr.21 datë 31/5/2016 të Kryetarit të Bashkisë Krujë, "Për disa ndryshime e shtesa në strukturën organizative të bashkisë Krujë për vitin 2016", me propozim të kryetarit të bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e pagave të Administrates së Bashkisë Krujë dhe Njësive Administrative në perputhje me Strukturën Organizative të miratuar nga Kryetari Bashkisë me efekt zbatimi nga data 01.06.2016
2. Miratimin e shperblimit per vjetërsine në pune për punonjësit administrativ me efekt financiar nga data 01. 02. 2016.
3. Miratimin e shperblimit te kryetarëve të fshatrave që varen direkt nga kryetari i bashkisë në masën 10% të pagës së kryetarit të bashkisë dhe të kryetarëve të fshatrave të tjerë në masën 10% të pagës së administratoreve përkatës duke filluar nga data 01.02.2016.
4. Efektet financiare, do të përballohen nga buxheti i bashkisë për vitin 2016 i planifikuar për këtë qëllim.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Durrës.

N/Kryetari i Këshillit
Artur Karaj





BASHKIA KRUJË

Projekt- Vendim

“Për miratimin e pagave të Administratës së Bashkisë Krujë”.

Ne zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 “Per grupimin e njesive te vetqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve te pageve te funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë te njesive të Vetëqeverisjes Vendore”, bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në mbështetje të nenit 5/25 të ligjit nr.10405, datë 24.03.2015 " Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", ligjit nr.147/2015, datë 24.12.2015 "Për buxhetin e vitit 2016", VKB Nr. 28 datë 31/5/2016 "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Krujë, institucioneve në varësi dhe njesive administrative" dhe vendimi Nr.21 datë 31/5/2016 të Kryetarit të Bashkisë Krujë, “Për disa ndryshime e shtesa në strukturën organizative të bashkisë Krujë për vitin 2016”, po ju paraqesim për miratim projekt-vendimin “Për pagat e Administrates së Bashkisë Kruje dhe Njesive Administrative për vitin 2016”, i cili rregullon pagat sipas emertimeve dhe grupimeve në strukturën e re të ndara: për funksionet e zgjedhura e të emëruar, për nëpunësit civilë dhe për punonjësit administrativë, të cilët do të përfitojnë shtesë mbi pagë për vjetërsinë në punë, në masën 1% të pagës bazë (22 000) për çdo vit të plotë pune deri në 25 vjet që nga data 01.02.2016.

Në këtë projekt vendim përcaktohen pagat e sektorit të auditit të brendshëm i cili është shtuar në strukturën e bashkisë nga data 01.06.2016 me VKM nr.83 datë 03/02/2016 “Për krijimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm”, si dhe pagat e sektorit të emergjencave civile dhe kizave, krijuar me VKM nr.965 datë 02.12.2015, p.24 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave”, të cilat fillojnë nga data 01.06.2016. Gjithashtu në këtë projekt saktësohet trajtimi financiar i këshilltarëve e kryetarëve të fshatrave që varen direkt nga kryetari bashkisë, me 10% të pagës së Kryetarit të bashkisë. Ndërsa kryetarët e fshatrave në varësi të njesive administrative do të trajtohen me 10% të pagës së administratorit, që fillojnë nga data 01.02.2016.

Efektet financiare të këtyre pagave, do të përballohen nga fondi i planifikuar në buxhetin e vitit 2016 për këtë qëllim.

Bashkelidhur tabela perkatese me pagat sipas pozicioneve, klasave e kategorise, diplomes dhe vjetersise ne pune.

Dr.B.njerëzore
Mehmet Deliu

Dr. Ekonomisë dhe Financës
Xhevahire Xhafa

Shefe e Sektorit Juridik

Eglantina Subashi

Sekretari i Këshillit
Maliq Reçi

Kryetari Bashkisë
Artur Bushi

